



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2018:009012

Datë: 17.08.2018

Numri i dokumentit: 00103106

**P.nr.236/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Diana Sina dhe sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. Sh. nga fsh.B. K-D., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti- Përgjithshëm në Gjakovë, PP./nr.128/2018 të dt.21.05.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, **me dt.18.05.2018**, murr ketë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë, PP./nr.128/2018 të dt.21.05.2018, dhe kjo Gjykatë, jep këtë :

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I akuzuari:

**SH. SH.**,i biri B. dhe i ëmës R. , e gjinisë Rr. , data e lindjes... në fsh.B. K- D., ku edhe tani jeton, i martuar , i gjendjes te mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës. me ID. ....

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

Me datë 29.01.2018, rreth orës 17.00 në rrugën D.- Gj. , pikërisht në lagjen”D.” në Gj. , rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 120, lidhur me nenin 255 të ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor , duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia edhe pse ka qene i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë si pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij , por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund ta ndalojë shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar , në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “ VW G... , me targa të regjistrimit ....., me ngjyrë të kaltër , duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe duke mos mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë në rrugë , shkakton aksident trafiku ku si pasojë me pjesën e përparme ballore të automjetit e godet me në pjesën e pasme automjetin e markës “ R.L.”, me targa të regjistrimit ....., të cilën e drejtonte D. H. , me q,rast përpos dëmeve materiale në automjete , lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari D. H. , të konstatuara hollësisht me ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.V.K. të datës 27.02.2018.

**-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së .**

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73,dhe nenit 378 par. 6 - 1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarit i ,

**SH Q I P T O N**

Dënimin me gjobë në shumë prej **200,00.-€ (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhri ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPRK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 46 par.4 të KPPK-së ,i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20.-€ (njëzet euro)**.

I dëmtuari D. H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore të paguan shumën prej **20.00 €**, ndërsa për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumën prej **40.88 €**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gj., ka ngrit Aktakuzën PP//.nr.128/2018 të dt.21.03.2018, ndaj të akuzuarit Sh.Sh. nga fsh.B.K-D., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 te KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdher ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-ës gjeti se janë plotësuar kushtet me çka ka kryer vepër penale , rrezikim i trafikut publik neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së,, dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe ti shqiptoi ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës se nenit 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë ne 1 (një) vitë.

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Raporti i aksidentit me nr. ER-.....,
- Raporti i hetuesit mbi vend shikimin e aksidentit i dt.29.01.2018,
- Skica e vendit të ngjarjes të aksidentit të ndodhur me dt.29.01.2018 me nr. të rastit, ER-.....,
- Deklarata e të dyshuarit dhënë në Stacionin Policor, Sh.Sh. e dt.29.01.2018
- Deklarata e të dëmtuarit dhënë në Stacionin Policor, De. H. e dt.29.01.2018

- Raporti i Repartit të emergjencës nga Spitali rajonal "I. G." në Gjakovë, me nr...., të dt.29.01.2018,
- Foto-dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, dhe shkresat tjera në lëndë,
- Akt ekspertimi mjeko-ligjor i Dr.V. K. dt.27.02.2018,
- Ekspertiza e Aksidentit në Komunikacion e Ing. të Komunikacionit Y. K. , PP.nr.211/18 e dt.25.02.2018.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 te KPK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 dhe pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr.236/18 te dt.18.05.2018**

**Sekretarja juridike:**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtroj Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarës të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:009012  
Datë: 17.08.2018  
Numri i dokumentit: 00103106